



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.152/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit për deputet të PDK-së, Kadri Kryeziu, në trafostacione elektrike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

#### VE N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.152/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

#### A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 30 Shtator 2019 rreth orës 16:00, zyrtarë të shtabit zgjedhor të LDK-së, në Prizren, kanë vërejtur dhe fotografuar vendosjen e një foto-posteri të kandidatit për deputet nga radhët e PDK-së, Kadri Kryeziu, për qëllime elektorale nga subjekti politik PDK, në trafo stacione elektrike (pronë publike), rruga “Ulqini”. Lagja “Arbana” Prizren.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika b i LZP-së, dhe me rregullat zgjedhore 11/2013 dhe 13/2013. Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuar.

Në përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2019, subjekti politik PDK, thekson se vendosja e posterit është bërë nga simpatizantë e pa informuar për rregullat zgjedhore, dhe për vendosjen e posterit të kandidatit për deputet Kadri Kryeziu në trafostacion elektrik (pronë publike) në Prizren, është marrë masa përmirësuese duke e larguar nga vendi në fjalë.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur foton si dëshmi për masën përmirësuese të kandidatit në fjale dhe deklaratën noteriale të kandidatit për deputet lidhur me respektimin e Kodit Zgjedhor.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së, e që në rastin konkret fotografia e ofruar nga ankuesi për vendosjen e posterit të kandidatit për deputet të subjektit politik PDK, në trafostacione elektrike, për panelin është e paqartë dhe nuk është bindëse për të vendosur ndryshe në këtë rast, ngase prej fotografisë që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet vendi dhe lokacioni se ku është vendosur, posterit në fjalë. Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme përshkrimet në ankesë se është thyer Kodi i Mirësjelljes nga subjekti politik PDK. Me këtë rast paneli konsideron se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafi 3 neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 5 paragrafi 7 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.152/2019 më datën 04.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.